



Republika e Kosovës  
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës  
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Prishtinë, më 07.09.2020

Drejtoria e Kulturës, Komuna e Prishtinës, në bazë të rregullores për ndarjen e subvencioneve nga Komuna e Prishtinës si dhe në bazë të rregullores MF-NR-04/2017 për Kriteret, Standardet dhe Procedurat e Financimit Publik për OJQ-të, hapë

## THIRRJE PUBLIKE

Për të gjitha organizatat joqeveritare, individët, bizneset e regjistruara në Republikën e Kosovës, programi i punës i të cilave është i fokusuar në fushën e kulturës, të aplikojnë për mbështetje financiare në *thirrjen publike të Fazës së II-të 2020*.

1. OJQ-të, individët dhe bizneset, në përputhje me këtë thirrje publike, mund të aplikojnë me projektpropozimet për organizimin e aktiviteteve kulturore si më poshtë:
  - a) **Art vizual – figurativ:** krijim i veprës së re, fuqizim i artistëve të rinj, ekspozitë, hulumtim kuratorial, instalime në hapësira publike, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;
  - b) **Botime:** për fëmijë, për të rinj, romane, tregime, përkthime, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe hulumtime kulturore;
  - c) **Kinematografi:** film dokumentar, filmi i shkurtër, film i animuar, fuqizimi i kinematografëve të rinj, titrim dhe zhvillim skenari;
  - d) **Muzikë:** kompozim i veprës së re, audio-incizim, koncert, fuqizimi i muzikantëve të rinj, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;
  - e) **Trashëgimi kulturore dhe turizëm:** fushata vetëdijësimi, pjesëmarrje në aktivitete për mbrojtjen e trashëgimisë kulturore, hulumtim, promovim i diversitetit kulturor, turizëm kulturor, platforma informative;

- f) **Teatër:** prodhimi i shfaqjes, promovim dhe pjesëmarrje e shfaqjes në festival kombëtare dhe ndërkombëtare, mbështetje të personave me nevoja të veçanta dhe inovacion teknologjik;

**2. Vlera e përgjithshme e planifikuar për Fazën e II-të është 100,000.00€ (Euro).**

Shuma minimale e mbështetjes financiare që mund të alokohet për një projekt është 500.00€ (Euro), ndërsa shuma maksimale për një projekt është 13,000.00€ (euro).

Afati për dorëzimin e propozimeve është nga dt. 08.09.2020 deri më 28.09.2020, ora 23:59.

Periudha e zbatimit të projektit është deri në fund të muajit dhjetor 2020.

**3. Kriteret për pjesëmarrje në thirrjen publike të subvencioneve për kulturë:**

- Të drejtë aplikimi kanë OJQ-të dhe bizneset të cilat janë të regjistruara në Republikën e Kosovës;
- OJQ-të dhe bizneset të cilat veprojnë në Komunën e Prishtinës dhe realizojnë aktivitetin e tyre në Komunën e Prishtinës;
- Individët të cilët janë banor rezidentë të Komunës së Prishtinës;
- OJQ-të, bizneset dhe individët mund të subvencionohen vetëm një herë brenda vitit nga Komuna e Prishtinës;
- OJQ-të, bizneset dhe individët nuk mund të përfitojnë me dy ose më shumë projekte nga subvencionet e Komunës së Prishtinës brenda një viti, qoftë edhe në kategori të ndryshme.
- OJQ-të, bizneset dhe individët, të cilët nuk kanë përmbyllë raportin e subvencioneve të viteve paraprake nuk kanë të drejtë të përfitojnë nga subvencionet e Komunës së Prishtinës në këtë thirrje;
- OJQ-të, bizneset dhe individët, të cilët nuk kanë pranuar mjete nga burime tjera të financimit për të njëjtat aktivitete (për të njëjtat linja buxhetore);
- Duhet të mos ekzistojë ndonjë konflikt interesi në mes të aplikuesit, përkatësisht përfaqësuesve/udhëheqësit të aplikuesit dhe organizatës

buxhetore apo institucionit publik, siç parashihet me legjislacionin në fuqi parandalimin e konfliktit të interesit në Republikën e Kosovës;

- Për të gjitha projektet që planifikohet të realizohen në shkollat e Komunës së Prishtinës apo me nxënësit e shkollave të Komunës së Prishtinës, paraprakisht duhet të merret pëlqim në Drejtorinë Komunale të Arsimit (DKA) për zhvillimin e projektit.
  - Si dhe kufizimet tjera të cilat janë parapara me rregulloren për subvencione në Komunën e Prishtinës.
4. Propozimet dhe dokumentet e kompletuara duhet të dorëzohen vetëm përmes aplikacionit online, në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Prishtinës <http://krs.prishtinaonline.com/>
- Aplikacionet, të cilat nuk e kanë dokumentacionin e detyrueshëm të kompletuar do të diskualifikohen.
  - Dokumentet nuk pranohen pas mbylljes së thirrjes publike.
  - Ngarkimi i dokumentit të gabuar ose jo të skanuar mirë, me pamje jo të qartë konsiderohet si mungesë e dokumentit.
  - Nuk do të pranohet ndryshimi i subjektit të aplikantit nga individ në OJQ apo biznes, apo cilindo variant tjetër, pas përfundimit të aplikimit. E njëjta vlejë edhe për ndryshim të xhirollogarisë.
  - Të gjithë aplikantët të cilët kanë ndërruar të dhënat e tyre duhet të sigurohen që t'i përditësojnë informatat e tyre në sistem gjatë periudhës së afatit të aplikimit për subvencione . Kontrata do të gjenerohen nda sistemi andaj të dhënat e sistemit reflektohen në kontratë.

Do të konsiderohen për mbështetje financiare vetëm projektet që janë pranuar brenda afatit të paraparë me këtë thirrje publike, dhe të cilat i përmbushin plotësisht kushtet e përcaktuara sipas thirrjes publike.

Procesi i pranimit, hapjes dhe shqyrtimit të aplikacioneve, vlerësimit të aplikacioneve, kontraktimi, dhënia e fondeve, koha dhe mënyra e parashtrimit të ankesave, trajtimi i dokumentacionit dhe kalendari tregues i zbatimit të thirrjes, janë të detajuara në [Rregulloren për subvencione](#).

Të gjitha çështjet që lidhen me thirrjen publike mund të sqarohen vetëm në mënyrë elektronike, duke dërguar e-mail në adresën: [kultura.pr@rks-gov.net](mailto:kultura.pr@rks-gov.net), dhe në numrin e telefonit +383 38226417. Pyetjet mund të bëhet deri me dt. 18.09.2020.

## Lista e dokumenteve të detyrueshme të thirrjes publike

- Aplikacioni online;
- **Për individ:**
  - ❖ Kopja e letërnjoftimit/ pasaportës
  - ❖ Vërtetimi/ Konfirmimi i llogarisë bankare (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
  - ❖ Çertifikata e vendbanimit
  - ❖ Konfirmim nga Drejtoria e Kulturës që keni përmbyllur projektin paraprak;
- **Për Ojq-të:**
  - ❖ Çertifikata e regjistrimit e OJQ-së;
  - ❖ Çertifikata e nr. fiskal;
  - ❖ Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të OJQ-së (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
  - ❖ Kopja e letërnjoftimit/ pasaportës së përfaqësuesit të OJQ-së.
  - ❖ Konfirmim nga Drejtoria e Kulturës që keni përmbyllur projektin paraprak;
- **Për Biznese:**
  - ❖ Çertifikata e Biznesit;
  - ❖ Çertifikata e nr. fiskal të Biznesit;
  - ❖ Vërtetimi/Konfirmimi i llogarisë bankare të Biznesit (nuk pranohet kopje e kartelës bankare);
  - ❖ Kopja e letërnjoftimit/ pasaportës të përfaqësuesit të Biznesit;
  - ❖ Konfirmim nga Drejtoria e Kulturës që keni përmbyllur projektin paraprak;

## **Lista e dokumenteve specifike të thirrjes publike sipas kategorive:**

### **1. Art Figurativ:**

- A. Portfolio e artistit/es/kolektivit;
- B. Prezentim i punimeve që do të ekspozohen; (Për instalacione/skulptura/intervenime në hapësirë publike);
- C. Koncepti vizual i veprës;
- D. Pëlqimi paraprak prej drejtorisë për shërbime publike për lokacionin e veprës;

### **2. Botime:**

- A. Biografia e autorit/es;
- B. Recenzioni;
- C. Një pjesë e veprës që do të botohet (Nëse ka ilustrime për fëmijë);
- D. Prezentim i ilustrimeve;
- E. Marrëveshje e nënshkruar me shtepinë botuese (Nëse ka).

### **3. Kinematografi:**

#### **3.1 Zhvillim skenari:**

- A. Link i punëve të mëhershme të regjisorit/es;
- B. CV të autorit/es ose link i punëve të mëhershme të autorit/es;
- C. Sinopsisi;
- D. Një pjesë e skenarit (p.sh. 10 faqe).

#### **3.2 Prodhim filmi artistik**

- A. Link i punëve të mëhershme të regjisorit/es;
- B. Ekipi kreativ me bio të shkurta (regjisor/ja, skenaristi/ja, rolet kryesore, DoP -drejtori/ja i-e fotografisë, nëse ka);
- C. Skenari;
- D. Sinopsisi;
- E. Koncepti regjisorial ose/dhe një video mesazh i regjisorit/es.

#### **3.3 Prodhim filmi dokumentar**

- A. Link i punëve të mëhershme të regjisorit/es;

- B. Ekipi kreativ me bio të shkurta (regjisor/ja, skenaristi/ja, rolet kryesore, DoP- drejtori/ja i/e fotografisë nëse ka);
- C. Koncepti i dokumentarit/tritmenti;
- D. Personat/Karakteret kryesor në film dhe përshkrimi i tyre;
- E. Koncepti regjisorial ose/ dhe një video mesazh i regjisorit/es;
- F. Në rast se ka material, një link ku mund të shihet (rreth 5-10min).

### 3.4 Postproduksion

- G. Link i punëve të mëhershme të regjisorit/es;
- H. Ekipi kreativ me bio të shkurta (regjisor/ja, skenaristi/ja, rolet kryesore, DoP- drejtor/ja i/e fotografisë nëse ka);
- I. Skenari;
- J. Sinopsisi;
- K. Koncepti regjisorial ose/ dhe një video mesazh të regjisorit/es;
- L. Linku i filmit ose një klip prej filmit.

### 3.5 Animacion

- A. Link i punëve të mëhershme të regjisorit/es;
- B. Ekipi kreativ me bio të shkurta (regjisor/ja, skenaristi/ja, ilustruesi/ja/it, animatorët);
- C. Skenari ose storyboard me përshkrim;
- D. Moodboard ose shembuj të karaktereve dhe stilit të animacionit ose/ dhe skica;
- E. Sinopsis;
- F. Koncepti regjisorial ose/ dhe një video mesazh të regjisorit/es.

## 4. Muzikë

- A. Link i punëve të mëhershme të artistit-es, i-e cila aplikon ose që është bartës-s i-e projektit.
- B. Ekipi kreativ me bio të shkurta (vokalist/ja, muzikantët/ja, kompozitori-ja);
- C. Teksti i këngës (nëse është e aplikueshme);
- D. Sinopsisi i video klipit (kur aplikohet për video klip);
- E. Koncepti regjisorial (kur aplikohet për video klip);
- F. Punë të mëhershme të regjisorit-es (kur aplikohet për video klip).

## 5. Trashëgimi kulturore dhe turizëm:

- A. Portfolio e organizatës me punë të ngjashme ose linqe të punëve të ngjashme të autorit-es;
- B. Projekt propozim (Preferohet që në projekt të ketë profesionist të fushës së trashëgimisë dhe të turizmit ) ;
- C. Koncepti vizuel (aty ku është e zbatueshme);
- D. Ftesa/marrëveshja (kur aplikohet për pjesëmarrje në aktivitete, punëtori, hulumtime, etj);

## 6. Teatër:

- A. Biografia e regjisorit/es;
- B. Biografia e autorit/es (nëse janë autorë vendorë);
- C. Koncepti regjisorial;
- D. Sinopsisi i dramës;
- E. Një pjesë e dramës (p.sh. 10 faqet e para);
- F. (Nëse ka) Marrëveshje e nënshkruar me teatrin.

*Afati për dorëzimin e propozimeve është deri më **28.09.2020** përmes aplikacionit online, në dispozicion në faqen e internetit të Komunës së Prishtinës <http://krs.prishtinaonline.com/>*